



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit



Shkresë	13.04.2023
Nga:	ZPP GEZIM HAJDINI
PER:	Avokatura Istrefi ShPK
Lenda :	VENDIM



Konform Ligjit mbi Prokurimin Publik nr 04/L-042, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr 05/L-068 dhe ligjin nr 05/L-92 Ligji mbi Prokurimin publik ne Kosovë,përkatesisht neni 108/A pika 2 dhe neni 6 pika 1 e Rregullave për parashtrimin e kerkesave për Rishqyrtim per Vendim te Autoritetit Kontraktues , Zyra e Prokurimit në Drenas nxjerrë :

VENDIM

1.Refuzohet si e pabazuar kerkesat e operatorive ekonomik “Avokatura Istrefi ShPK.” kunder vendimit të autoritetit kontraktues “ShërbimAutoriteti e të përfaqësimit në procedura gjyqësore për nevoja të Komunës së Drenasit” me nr 611-23-1507-2-1-1 si e pabazuar .

OE ka paraqitur kerkesë për rishqyrtim te AK me datën 12.04.2023 kunder vendimit te AK dhe refuzohet si e pabazuar .


Zyra e Prokurimit ka rishikuar edhe njëherë ofertën tuaj, dhe konkludon se ju jeni si operator i papërgjegjshëm për arsye se oferta juaj është në kundërshtim me Rregulloren për Tarifat e Avokatëve, ndërsa sa për informimin tuaj, Autoriteti ka të drejtë të përdorë të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi të RKS për vlerësimin e drejtë të tenderëve.

Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit nr.04/L-193 për Avokatinë, thotë “Avokati ka të drejtë për pagesën e honorarit dhe kompensimin e shpenzimeve për punën e tij në pajtim me Rregulloren për tarifën e avokatëve. Pra, çështja e tarifave për avokatët është çështje e cila e ka bazën në ligj. E në pajtim me ligjin e cekur me lartë, Kuvendi i Odës së Avokatëve të Kosovës, me datë 18 Mars 2027 ka nxjerr Rregulloren për tarifat e avokatëve e cila rregullon pagesat për tarifat për punën e avokatëve dhe kompensimin e shpenzimeve për punën e avokatëve.

Në rrjedh të kësaj për sa i përket çështjes së shërbimeve të kërkuara, sipas shpalljes publike të datës 07.04.2023, vlera e kompensimeve për pozicionet përkatëse të shpalljes është e vendosur konform shtojcave përkatësisht numrit 6 dhe numrit 7 tarifor të Rregullores së lartpërmendur.

Vendosja ndryshe nga që ka vendosur komuna e Drenasit si autoritet kontraktues, do të nënkuptonte shmangien, përkatësisht shkeljen e një rregullore cila është nxjerrë nga organi i autorizuar me Ligj (Kuvendi i Odës së Avokatëve), rregullore kjo e cila e ka bazën në ligj, andaj rrjedhimisht do të nënkuptonte edhe shkeljen e ligjit.

Ju po ashtu jeni i papërgjegjshëm për arsye se Formularin e Tenderit nuk e keni plotësuar në menyrë të drejtë pasi që validiteti i ofertës është 120 ditë – vlerë e madhe (shërbimë) , ndersa ju e keni paraqitur 90 ditë dhe çmimi i cili vendoset ne paramasë duhet të vendoset edhe ne formularin e tenderit andaj ju keni vepruar në kundërshtimë me Rregullorën e prokurimit Publik Neni 10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së



Mungesa	Mungesa të lëvizshme informacione	66
Mungesa certifikate ISO	Mungesa të lëvizshme informacione	69
Mungesa çmime	Refuzo tenderin pa lëvizshme informacione të mëtejshme	Kasht administrativ
CV-ja e detyrues me përmbajtje të lëvizshme	Refuzo tenderin pa lëvizshme informacione të mëtejshme	69
CV-ja e lëvizshme me shifra detyrues	Mungesa të lëvizshme informacione	69
CV-ja e detyrues me përmbajtje të lëvizshme, AK me mungesa të vendos	Mungesa të lëvizshme informacione	69
Mungesa shërbime me gjendje ekonomike dhe financiare	Mungesa të lëvizshme informacione	68

Dokument me gjendje ekonomike dhe financiare me përmbajtje të lëvizshme	Refuzo tenderin pa lëvizshme informacione të mëtejshme	68
Dokument me gjendje ekonomike dhe financiare me përmbajtje të lëvizshme	Refuzo tenderin pa lëvizshme informacione të mëtejshme	Kasht administrativ
Lista e çmimeve me përmbajtje të lëvizshme (tenderi e detyrues me formë fizike)	Refuzo tenderin pa lëvizshme informacione të mëtejshme	Kasht administrativ
Shërbimi i Tenderit me gjendje ekonomike dhe financiare me përmbajtje të lëvizshme	Refuzo tenderin pa lëvizshme informacione të mëtejshme	57
Lista e çmimeve me përmbajtje të lëvizshme	Refuzo tenderin pa lëvizshme informacione të mëtejshme	Kasht administrativ
Mungesa shërbime e qortë ku të gjendet tenderi e grupi për bashkëpunim dhe individuale	Refuzo tenderin pa lëvizshme informacione të mëtejshme	Kasht administrativ

Kundër këtij vendimi keni të drejtë ankese në OSHP në afatë prej 10 ditë .